39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi;
b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **615-25-5930-5-1-1/C1210**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		***Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK***
Përshkrimi i nenit	***Neni. Nr.***	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë **Gjuha Shqipe**.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 64,884.19 euro për kohëzgjatjen e periudhës prej 330 diteve nga koha e nënshkrimit të kontratesnga data 03.10.2025 deri me 03.10.2026
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda *[shëno numrin]* ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite nga koha e nënshkrimit te kontrates
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 300 ditë nga nenshkrimi i kontrates.

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë **0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës** për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	**Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit**
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Caktohet nga ZKA brenda 3 dite
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: *N/A*
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: *N/A*
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë **5** ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është **365** ditë nga koha e pranimit te punëve **10%** shumës së Kontratës
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është **përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.**
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	**Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë**
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të **dorëzohet ne Gjykaten Themelore ne Prishtine – Dega Podujeve në pajtim me ligjin në Kosovë.** ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të **Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.** a) **Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.**

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

OBJEKTI I ANEKSIT PËR SHKOLLËS "IBRAHIM RUGOVA "

LOKACIONI: PODUJEVË

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL PODUJEVË

VËREJTJE:

Gjatë realizimit të pozicioneve te kesaj paramase duhet referuar edhe: Përshkrimi Teknik , Projekti, Detajet, Skemat grafike dhe Specifikimet Teknike. Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punën, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale(te kompletuar), garancinë, prezentimin e certifikatave per produketet dhe certifikatave të prodhuesve me standarde ISO ose standarde te cilat jane te cekura ne pershkrim tekik apo paramase si dhe të prodhohen në përputhje me EC- standardet. Çmimi duhet të përfshijë gjithashtu të gjitha materialet shpenzuese deri në vuajen në punë. Llogaritja e sasive përfundimtare do të bëhet pas përfundimit të pozicioneve. Të dhënat teknike, dimensionet, sasitë, etj, nëpërmjet kësaj kontrate duhet të jenë me ISU - Sistemi Ndërkombëtar I Njësive (International System of Units). Të gjitha produktet e propozuara duhet të shoqërohen me një certifikatë cilësie të prodhuesit dhe të miratuar paraprakisht nga mbikëqyrësi. Në rast mospërputhjeje midis të dhënave në paramase dhe Pershkrim Teknik,ku pershkrimi teknik gjithmonë duhet te merret i pari, duke përjashtuar rastet e gabimeve teknike eventuale ku metoda më e favorshme eshte se duhet miratuar zgjidhja. Nëse për shkak të neglizhencës në punë shkaktohet dëmtim në zonën përreth kantierit dhe brenda kantierit, atëherë përgjegjësia për rregullimin i takon kontraktorit.Materiali i demoluar,mbeturina,dheu etj që nuk ka ndonjë vlerë konsiderohet pronë e pronarit dhe pronari do të japë udhëzime për asgjësimin apo deponimin e materialit të demoluar, ndërsa demolimi dhe transporti janë përgjegjësi e kontraktorit. Çmimi për skeleri duhet të përfshihet në çdo pozicion ku nevojiten për përfundimin e punimeve apo realizimin e atij pozicioni. Çmimet duhet të përfshijnë çdo aktivitet tjetër që nuk përshkruhet këtu, por që është i nevojshëm për përfundimin e punimeve apo realizimin e pozicionit. Kontraktori është i detyruar të bëjë matjet e të gjitha pozicioneve, para fillimit të prodhimit dhe furnizimit.Kontraktuesi/punekryesi duhet te i punoj dhe prezantoj detalet ekzekutive te nevojshme per realizimin e projektit dhe per te njejtat te marr aprovimin na inxhinjeret projektues te fazave. Per çdo ndryshim te projektit gjate realizimit apo ndryshim te materialit paraprallsht duhet te meret aprovimi nga projektuesi.

1	PUNËT NDËRTIMORE				
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtes me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina.	komplet	1	2,500.00 €	2,500.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërlimi i rjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	4,500.00 €	4,500.00 €
1.01.03	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim	komplet	1	2,500.00 €	2,500.00 €
1.01.04	Pastrimi i tërësishëm i objektit dhe terenit rreth objektit pas përfundimit të punimeve nga të gjitha ndërlimet e përkohshme, rrethoja, etj.	komplet	1	3,500.00 €	3,500.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.01	13,000.00 €

1.02	PUNËT E DEMOLIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.02.01	Te behet demolimi i murit me bloka nga argjila e pjekur tek pjesa e cila objekti lidhet me objektin ekzistues.Ne cmim llogaritet transporti i mbeturinave ne deponin me te afert.	m^2	9.60	20.00 €	192.00 €
1.02.02	Te behet demolimi i dritares nga materiali PVC tek pjesa ku lidhet objekti ekzisutes me aneksin. .Ne cmim llogaritet transporti i mbeturinave ne deponin me te afert.	cope	1	200.00 €	200.00 €
1.02.03	Te behet demolimi i radiatorit i cili ndodhet tek drilarja e cila ndodhet ne pjesen ku do te lidhet aneksi me objektin ekzistues.Gjithashtu te parashihet edhe rregullimi i nevojshem i gypave ne ate pjese ne menyre qe ngrohja te vazhdoj te punoj dhe te mos pengoj per krijimin e hapjes. .Ne cmim llogaritet transporti i mbeturinave ne deponin me te afert.	cope	1	650.00 €	650.00 €
1.02.04	Te behet demolimi i asfaltit,betonat ne hapesiren ku do te punohet objekti(aneksi)..Ne cmim llogaritet transporti i mbeturinave ne deponin me te afert.	m^2	80.00	13.00 €	1,040.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.02	2,082.00 €

1.03	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.03.01	Gërmimi i shtresës së humusit me trashësi 30 cm në tërë sipërfaqen e paraparë për pozicionimin e objektit, shtigjeve dhe pjesës së parkingut me rrugën e re. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. **Vërejtje:** Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkrifëtësisë. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m^3	348.60	2.20 €	766.92 €
1.03.02	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë për hapjen e themeleve të objektit, hapjen e themeleve te shkalleve emergjente. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. **Vërejtje:** Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkrifëtësisë.	m^3	1,370.60	1.80 €	2,467.08 €
1.03.03	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/31 nën tërë siperfaqen e themeleve shiritore duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Ms=30 MPa. **Vërejtje:** Për shkak të mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%	m^3	138.20	14.00 €	1,934.80 €
1.03.04	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/61 nën tërë siperfaqen e pllakes se dyshemese dhe themeleve shiritore duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Ms=30 MPa. **Vërejtje:** Për shkak të mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%	m^3	138.20	14.00 €	1,934.80 €
1.03.05	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës ne mes dhe përgjatë mureve të themeleve si dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/31 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë MS=30 MPa. **Vërejtje:** Mbushja të realizohet pas betonimit të mureve të themeleve perimetrike deri në kuotën për tërë gabaritin e objektit.	m^3	1,308.30	8.00 €	10,466.40 €
		TOTAL POZICIONI		1.03	17,570.00 €

1.04	PUNËT E BETONIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	VËREJTJE 1: Punëkryesi është i obliguar që të merr mostrat e betonit për çdo 'parti' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratore të specializuara për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat. **VËREJTJE 2:** Për pozicionet e parapara të betonohen me shtesa të specifikuara si më poshtë punëkryesi obligohet që të veproj sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbajtur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivet e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në praninë e organit mbikqyrës.				
1.04.01	Furnizimi me material dhe punimi i bazës për mbështetjen e elementeve të lidhura të armaturës së themeleve perimetrike. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.5 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të dy anët e shputës së themeleve.	m^3	51.90	72.00 €	3,736.80 €
1.04.02	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve shiritore perimetrike duke perfshire edhe cokullen me gjersi 25 cm . Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	515.30	80.00 €	41,224.00 €
1.04.03	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës së përdhesës në kuotën ± 0.00 me trashësi 20 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	148.50	110.00 €	16,335.00 €
1.04.04	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave të përdhesës me dimensione 25x80/50x30cm duke perfshire edhe pelhurat prej betoni. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	36.80	150.00 €	5,520.00 €
1.04.05	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës së meskatit dhe pllakes se fundit trashësi 22 cm duke përfshirë edhe trarët dhe konzollat në të gjitha anët. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	316.20	125.00 €	39,525.00 €
1.04.06	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave te kalit, peluhrave dhe cerklazheve horizontale dhe të pjerrëta për shtangimin e mureve të kallkanit/nënkulmit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	42.02	120.00 €	5,042.40 €
1.04.07	Furnizimi me material dhe betonimi i shkalleve te brendshme dhe te jashtme duke perfshire dhe elementet konstruktive. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	19.60	145.00 €	2,842.00 €
1.04.08	Furnizimi me material dhe betonimi i cerklazheve horizontale (trarët mbi dyer) si dhe ne perimeter te muril te atikes me dimensione 12x20 cm dhe 25x20 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	15.18	90.00 €	1,366.20 €
1.04.09	Furnizimi me material dhe betonimi i bazes se themeleve per shkallet metalike emergjente(2 pale shkalle) me trashesi 30cm si dhe bazen per mbeshtetjen e paisjeve te makinerise me trashesi 20cm, duke perfshire dhe elementet konstruktive. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m^3	32.70	90.00 €	2,943.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.04	118,534.40 €

1.05	PUNËT E ARMIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.				
1.05.01	Ø 8, Ø10, Ø12, Ø14,Ø16,Ø20	kg	98,576.98	0.80 €	78,861.58 €
		TOTAL POZICIONI		1.05	78,861.58 €

1.06	PUNËT E MURATIMIT				
	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL
1.06.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25 me bllloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMall" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m^3	340.60	95.00 €	32,357.00 €
1.06.02	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 20 me bllloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMall" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m^3	9.10	95.00 €	864.50 €
1.06.03	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 12 cm me bllloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMall" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim. Ne qmim te perfshihet edhe leshi i gurit me trashesi 5cm ne mes te mureve sandwich.	m^3	8.20	160.00 €	1,312.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.06	34,533.50 €

1.07	PUNËT E SUVATIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.07.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i plafoneve si dhe suvatimi i sipërfaqeve të brendshme të mureve deri në nivelin e plafonit në të gjitha kthinat në përdhesë dhe katë me material/llaç të parapërzier si RÖFIX 510 (gëlqere+çimento+agregat) ose me material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaç sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listellat metalike për caktimin e trashësisë së llaqit, këndoret metalike, listellat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rrjetë armimi dhe shirit velngjitës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdrukthtarisë me folie të PVC-së si dhe rrjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si bllloqe-beton.	m^2	3,135.60	7.00 €	21,949.20 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve me dy shtresa gletmasë (secila me trashësi së paku 1 mm) RÖFIX 225 ose material të ngjashëm në të gjitha kthinat të cilat shfrytëzohen më intensivisht nga personeli	m^2	2,968.60	5.50 €	16,327.30 €
		TOTAL POZICIONI		1.07	38,276.50 €

1.08	PUNËT E NGJYROSJES				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.08.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani me aftësi të madhe të pastrimit si StoColor Puran. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyerje bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m^2	2,968.60	1.00 €	2,968.60 €
1.08.01	Furnizimi me material si dhe ngjyrosja e mureve te koridorit me ngjyre yndyrore deri ne lartesi te murit h=140cm.	m^2	429.00	1.30 €	557.70 €
		TOTAL POZICIONI		1.08	3,526.30 €

1.09	PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESË				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.09.01	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në të gjitha kthinat e brendshme ne dy katet me dysheme nga pllakat qeramikës duke përfshirë , shtresat termoizoluese dhe zëizoluese si dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi i nivelizimit me shtresat si në vijim: • Estrih me trashësi 5 cm • Folie/nënshtresë alumini për ngrohje gypore në dysheme • **Austrotherm EPS® A100**	termoizolim me trashësi 3 cm • **Austrotherm EPS® T650**	izolim akustik me trashësi 2 cm	m^2	1,144.00	11.50 €	13,156.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.09	13,156.00 €

1.10	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.10.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i kthines teknike ne nyjet sanitare dhe depos duke përfshirë hidroizolimin e dyshemesë në këto kthina si dhe hidroizolimin e mureve 15cm me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex të aplikuar në dy shtresa . Në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të pollesterit ose rjetave me fije qelqi në këndе për të penguar plasaritjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe afatet e përcaktuara nga prodhuesi.	m^2	156.80	8.00 €	1,254.40 €
		TOTAL POZICIONI		1.10	1,254.40 €

1.11	PUNËT E DYSHEMES|LINOLEUM|QERAMIKËS | GRANITIT | KUARCIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	290	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.11.01	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë nga linoleumi në të gjitha hapësirat e përcaktuara me projekt në të dy nivelet e objektit. Ngjyra e linoleumit të përcaktohet në koordinim me organin mbikqyrës të caktuar nga investitori. Dyshemeja të punohet me shtresat në vijim: • Shtresa finale e linoleumit me trashësi min.4 mm, me ngjyrë dizajn të përzgjedhur në koordinim me organin mbikqyrës • Ngjitës adekuat për linoleum • Masë autonivelizuese për eliminimin e poreve dhe plasave në estrih.	m^2	915.00	15.50 €	14,182.50 €
1.11.02	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës këndore në formë "L" për mirëmbajtje më të lehtë të dyshemeve nga linoleumi në të gjitha hapësirat e përcaktuara me projekt në të dy nivelet e objektit. Ngjyra e profilit të cokllës të përcaktohet në koordinim me organin mbikqyrës të caktuar nga investitori. Cokla duhet të jetë kompatibile me dyshemenë e montuar, me dimensione së paku 7x7 cm në varësi nga tipet që ofrohen nga prodhuesi i linoleumit.	m^1	541.30	3.20 €	1,732.16 €
1.11.03	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë tek kthinen teknike, nyjet sanitare ,depo me pllaka qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuar nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfituesit e objektit. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m^2	182.05	25.00 €	4,551.25 €
1.11.04	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës për mirëmbajtje më të lehtë të hapësirave me mure të suvaluara të cilat janë të shtruara me pllaka qeramike. Cokla të punohet me pllaka të glazuara qeramike me lartësi 10 cm, me ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përzgjedhur në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si.	m^1	121.60	6.50 €	790.40 €
1.11.05	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve deri në lartësinë e plafonit tek nyjet sanitare me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuara nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfituesit e objektit. Pllakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m^2	262.60	23.00 €	6,039.80 €

1.11.06	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të brendshme duke përfshirë pushimoren, basamakët (shkelëset dhe ballorët), cokllën e shkallëzuar rreth mureve dhe shkallën e fundit në tërë gjerësinë e kafazit të shkallëve. Të gjitha sipërfaqet të vishen me pllaka të poliruara graniti me trashësi 2 cm (ballorët dhe cokila 2 cm). Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m^2	35.20	65.00 €	2,288.00 €
1.11.07	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të jashtme tek hyrjet objektit në objekt, mveshja me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë të përpunuar me flakë. Të gjitha sipërfaqet horizontale, vertikale dhe ato të pjerrëta të vishen me pllaka graniti me trashësi 2 cm duke përfshirë edhe pjesët anësore të shkallëve deri në kuotën e përcaktuar në projekt, duke përfshirë cokllën me lartësi 10 cm në pjesët ku shkallët bashkohen me fasadën e objektit. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m^2	75.90	68.00 €	5,161.20 €
1.11.08	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave të kuarcit për parapetin e të gjitha dritareve. Pllakat duhet të ngjiten me ngjitës adekuat për kuarc dhe në anën e poshtme duhet të kenë të gdhendura kanalet për pengimin e rjedhjes së ujit në drejtim të murit. Parapeti të realizohet me 1 pllakë të vetme (pa vazhdime). Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shirita ekspandues hidroizolues dhe silikon sanitar. Trashësia 2 cm Gjerësia 23 cm (së paku 2 cm duhet të dalin jashtë murit) Ngjyra e bardhë	m^1	35.20	18.00 €	633.60 €
		TOTAL POZICIONI		1.11	35,378.91 €

1.12	PUNËT E ZDRUKTHTARISË | DYERT DHE DRITARET				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	"Furnizimi trasporti dhe montimi i Dritare PVC 80-85mm, me ngjyre te bardhe RAL 9016 me hapje dhe kiperim. Qelqi i dritareve: Transparent | Termopan | 4+10+4+14+4mm/Low-E + Argon Qelqi i dyerve: Transparent | Termopan | 6+14+4mm/Low-E + Argon Paneli termoizolues: STADUR F8-4 Aluminium | Sandwich element nga llamarinat e alumini me trashësi 1 mm me mbushje. Punimi i dritareve duhet të bëhet sipas skemës dhe pershkrimit. Prodhuesi (Salamander, Aluplast, Trocal, Rehau apo ndonjë prodhues tjeter me karakter të ngjajshem)."				
1.12.01	**POS D-01** - Derë dykrahëshe PVC Dimensionet: 250x275cm. Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	4	890.00	3,560.00 €
1.12.03	**POS W01** Dritare katerkrahëshe. Të gjitha mbushjet me qelq termopan. Dimensionet: 330x180 cm Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	24.00	730.00 €	17,520.00 €
1.12.04	**POS W02** Dritare peskraheshe Të gjitha mbushjet me qelq termopan i zalluar. Dimensionet: 400x180 cm Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	4.00	890.00 €	3,560.00 €
1.12.04	**POS W03** Dritare trikraheshe Të gjitha mbushjet me qelq termopan i zalluar. Dimensionet: 300x180 cm Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	1.00	680.00 €	680.00 €
1.12.04	**POS W04** Dritare dykraheshe Të gjitha mbushjet me qelq termopan i zalluar. Dimensionet: 220x80 cm Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë	copë	8.00	300.00 €	2,400.00 €
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme për shumë qëllime. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: H3D Multi Purpose Door me mbushje nga leshi mineral - me trashësi 45 mm. Korniza e derës: dypjesëshe e kombinuar - nga korniza këndore me ankerë dhe dipla dhe kontra-kornizë,dyert e klasëve të posedojn dritaren e vogel per mundesi transparences. Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak standard të zgjatur vertikal dhe profil për cilindër Mënteshat: 3 pjesësh për pesha të mëdha Ngjyra: E kaftë (Ngjajshem me dyert ekzistuese) Mbyllësi hidraulik: Standard				

1.12.05	POS D02 Derë njekrahëshe me mbindricim dhe me hapje te dritares. Qelq termopan, Dimensionet: 100x275 cm Dizajni sipas skemës së zdrukthtarisë,	copë	21.00	595.00 €	12,495.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.12	40,215.00 €

1.13	PUNËT E FASADËS				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.13.01	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës termoizoluese të tipit StoTherm Vario nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër i ngjashëm i prodhuesve tjerë. Sistemi StoTherm Vario duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja bazë | StoPrep Contact • Ngjitës | StoLevell Uni • Termoizolim | Austrotherm EPS AF - t=10cm • Rrjetë Armimi | Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese | StoLevell Uni • Lyerja bazë | StoPutzgrund Nature • Llaç strukturat organik | Stoispolit Kratz K 2.0 mm • Ngjyrë vetpastruese | StoLotusan Në çmim duhet të përfshihen trajtimi adekuat sipas projektit e te gjitha pjeseve horizontale dhe vertikale duke perfshire të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, listellat dilatuese (anputzleiste) për dritare dhe dyer, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e dilatimit në fasadë, mbajtësit konzollë për dritare dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m^2	355.3	21.00 €	7,461.30 €
1.13.02	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës me tulla me shtresat si në vijim: • Tullë e kuqe belge ose e ngjajshme | t=6cm • Hapsire ajrosje 4cm • Termoizolim | lesh mineral , t=10cm • Ankerat per shtangim fasades • Pllaka metalike mbi dyer/dritare e fiksuar me ankera | t=10mm • membrana difuzive Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si ankerbulona, ngjites, mbushje polluretan, distancer, profilet fleksibile për fugat e dilatimit në fasadë, dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues per kompletimin e pozicionit. **Vërejtje:** Te punohen me kujdes pjeset e hapjeve, ankerimit dhe shtresat e tartecekura.	m^2	984.5	50.00 €	49,225.00 €
1.13.03	Furnizimi me material dhe punimi i strehes ne perimeter te objektit nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër të ngjashëm të prodhuesve tjerë. Streha termoizoluese duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja bazë | StoPrep Contact • Ngjitës - masë hidroizoluese | StoFlexyl • Termoizolim | Austrotherm XPS AF - t=5cm • Rrjetë Armimi - Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese | StoFlexyl • Lyerja bazë | StoPutzgrund Nature • Llaç dekorativ shumëngjyrësh | StoSuperlit K 2.0 mm Streha duhet të realizohet nga pjesa e traut deri ne pjesen ballore ku eshte vendosur konstruksioni i drurit Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e dilatimit në fasadë, dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues. **Vërejtje:** Shtresa termoizoluese është e përfshirë te punët termoizoluese si pjesë e një tërësie më të madhe.	m^2	154.0	20.00 €	3,080.00 €

1.13.04	Furnizimi dhe montimi i pikoreve nga alumini me trashësi 2 mm për të gjitha drifaret e jashtme në fasadë. Gjerësia e pikores duhet të jetë së paku 3 cm jashtë fasadës. Materiali: Alumin i plastifikuar Ngjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt Në çmim të përfshihet edhe goma izoluese vetngjitëse EPDM për mbylije të fugës mes pikores dhe profilit të dritares, kapakët skajor, mbajtësit konzollë në distancë jo më të madhe se 50 cm dhe të gjitha mjetet tjera të nevojshme për fiksimin e pikoreve. Gjeresia e pikores ~30cm.	m^1	154.0	13.00 €	2,002.00 €
1.13.05	**VESHJE MASKUESE NGA PLLAKAT E GJIPSKARTONIT** Furnizimi me material dhe veshja/maskimi i vertikaleve dhe horizontaleve të kanalizimit sipas projektit në të gjitha nivelet me pllaka gjipskartoni rezistent ndaj lagështisë KNAUF – Platte Imprägniert H2 - EN520 12.5 mm duke përfshirë nënkonstruksionin metalik, mbushjen e fugave, bandazhimin si dhe patinimin e tërë sipërfaqes me një shtresë glet-masë.	m^2	108.60	14.00	1,520.40 €
		TOTAL POZICIONI		**1.13**	**63,288.70 €**

1.14	PUNËT E KULMIT DHE LLAMARINËS				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.14.01	KULMI I RRAFSHTE Furnizimi, transporti, vendosja, punimi dhe montimi i shtresave sipas pershkrimit me poshte, ku perfshihen shtresat sipas radhitjes: Zhavorr i lumit 0.4(t=5-7cm) (t=5-7 cm) Gjeotekstil 300 gr/m2 Membrana Hidroizoluese SikaPlan SgmA t=1.5mm - PVC apo(bauder) Gjeotekstil 300 gr/m2 Betoni me ramje t=5-15cm Termoizolim POLISTEROL XPS t=10cm Termoizolim POLISTEROL XPS me lartesi te ndryshme 3 deri 8 cm. Penda e Avullit SARNAVAP 500E Ne çmim te kalkulohen te gjitha keto shtresa, gjithashtu punimet duhet te behen nga persona te kualifikuar per keto lloj izolimesh si dhe materialet duhet te jenë te certifikuara. Vërejtje: ne kete çmim ne kulmin e rrafshte duhet te parashihen edhe ajrosja e kulmit ne pozicione sipas udhezimeve te prodhuesit	m^2	870.90	40.00 €	34,836.00 €
1.14.02	Furnizimi dhe montimi profesional i ujembledhesave adekuat per kulme te rrafshta nga prodhuesi i njejte me materialin Hidroizolues duke perfshi edhe çdo material dhe puna qe	cope	10.00	50.00 €	500.00 €
1.14.03	Punimi dhe hapja e vrimave emergjente per largimin e ujit nga te gjitha kulmet e rrafshta, ne lartesine adekuate sipa specifikave dhe detaleve ne projekt.	cope	5.00	30.00 €	150.00 €
1.14.04	Hidroizolimi dhe Termoizolimi i Atikave ne Kulmet e rrafshta pasi te betonohet atika sipas detalit behet Furnizimi dhe punimi i shtresave izoluese dhe mbrojta e izolimit si ne vijim: Styrodur t=5 cm nga ana e brendshme, Gjeotekstil, pesha g=300 gr/m2 ,membrana hidroizoluese elastike PVC Sika plan 14.6, trashesia 2.0 mm Gjeotekstil, pesha g=300 gr/m2 , dhe mveshja me llamarine. ne çmim te kalkulohen shtresat e shenuara, gjithashtu punimet duhet te behen nga persona te kualifikuar per keto lloj izolimesh si dhe materialet duhet te jenë te çertifikuara Verejtje: ne kete pos. jane te perfshira edhe izolimet evntuale te vrimave te qfardo instalimeve ,ujembledhesat horizontal deri te ulluqet me materialin e njetë.	m^2	155.90	20.00 €	3,118.00 €
1.14.05	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e pikoreve horizontale ne kulmin e rrafshët me llamarinë të zinkuar d=0.6mm gjeresia e atikave t~45cm dhe të plastifikuar të	m`	159.50	12.00 €	1,914.00 €
1.14.06	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e ulluqeve vertikale me formë rrethore me diametër Ø-125mm për largimin e ujit atmosferik nga sipërfaqja e kulmit me llamarinë të zinkuar d=0.6mm dhe të plastifikuar të ngjyrosur me nuancë të caktuar sipas projektit dalojne varesisht ne cilen ane te fasades jane. Mbajtësit e ullukut vendosen në distancë max.2.0m në vertikale. Ulluqet vertikale vendosen në pozicionet e caktuara sipas projektit.ne kete posicion hyne edhe 27 kokat e jashtme te ulluqeve qe lidhen me fasade	m`	65.00	10.00 €	650.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.14	41,168.00 €

1.15	PUNËT E NDRYSHME				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL

1.15.01	Furnizimi me material dhe punimi i shkallëve emergjente për evakuim në rast rreziku nga zjarri(dy pale shkalle). Konstruksioni i shkallëve duhet të punohet me profilet sipas paraqitjes grafike. Mbrojtja e konstruksionit metalik nga korozioni me 2 shtresa ngjyrë bazë (primer) dhe dy shtresa ngjyrë të yndyrshme me nuancë sipas zgjedhjes së investitorit. Paraprakisht të pastrohen të gjitha sipërfaqet metalike nga pluhuri dhe korozioni. Vërejtje: Të gjitha profilet metalike duhet të jenë të reja, të papërdorura, të padëmtuara dhe pa shenja korozioni. Të merren të gjitha masat që të mbrohen nga korozioni gjatë deponimit të tyre. Të gjitha punët e saldimit duhet të kryhen nga saldues të çertifikuar. Saldimet të jenë të plota, uniforme, pa vrima të cilat nuk mund të mbrohen nga korozioni. Të gjitha vijat kontaktuese në mes të profile duhet të jenë plotësisht të mbyllura me saldim. Në çmim duhet llogaritur edhe ankerimi me bazen e betonit si dhe te gjithe aksesoret e nevojshem per realizimin e ketij pozicioni sipas detalit.	kg	8,449.00	1.60 €	13,518.40 €
1.15.02	Furnizimi me material dhe shtrimi i shtigjeve rreth objektit dhe para hyrjeve kryesore me kubëza nga betoni i presuar me vibrim me dimensione 35x40 cm dhe trashësi t=6 cm, me sipërfaqe të parrëshqitshme, me dizajn të kombinuar me kubëza me ngjyrë natyrale të betonit dhe ngjyrë tjetër opcionale. Në çmim duhet të përfshihet: 1.Germimi i hapesire ne thellesi 30cm 1. Ngjeshja me makineri deri në arritjen e kompaktësisë Ms=80MPa 2. Shtresa e zhavorit 0-60 mm me trashësi 20 cm. 3. Shtresa e zhavorit 0-31 mm me trashësi 10 cm 4. Shtresa e zhavorit 4 - 8 mm me trashësi 5 cm dhe 5. Finalizimi me mbushjen e fugave. Kubëzat duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, rezistenca në fërkim dhe gërryerje, qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të kripërave për shkrirjen e akujve, të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos thithin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338:2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.	m^2	481.00	22.00 €	10,582.00 €

1.15.03	Furnizimi me material dhe kullizimi i shtigjeve rreth objektit dhe platove para hyrjeve kryesore me gure skajore nga betoni i presuar me vibrim, me dimensione 8x20x100 cm dhe ngjyre natyrale te betonit duke perfshire edhe punimin e bazamentit me beton. Gurët skajor duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të kripërave për shkrirjen e akujve, të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos lihthin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338:2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.	m'	319.00	6.00 €	1,914.00 €
1.15.04	Furnizimi me material transporti dhe punimi i gardhit të shkalleve metalike per dalje emergjentenga konstruksioni metalik sipas detale te projekti rrethoja të punohet me profile Ø40x40x3 mm të ankeruara në pjesët e epërme të rampave me anë të pllakave të me dimensione 100x100x5 mm me anker bulona. Mbajtësit kryesor montohen në distancë 120 cm. Dorëza e gardhit për të rritur të punohet nga tubi Ø60x3 mm në lartësi 100 cm ndërsa dorëza e gardhit për fëmijë nga tubi Ø 60x3 mm në lartësi 60 cm. Mbushja e rrethojës të bëhet me shufra Ø 10 mm në çdo 10 cm. Mbrojtja e rrethojës metalike duhet të bëhet me anë të lyerjes me dy shtresa ngjyrë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të yndyrshme të cilat në mes veti duhet të ndryshojnë për nga një nuancë. Ngjyra finale duhet të jetë e hirtë Antracit.	m'	39.20	62.00 €	2,430.40 €
1.15.05	Furnizimi me material dhe punimi i gardhit të shkallëve të brendshme sipas detaleve në projekt me profile inoksi Ø40x40x3 mm të ankeruara në pjesët anësore të krahëve të shkallëve me anë të pllakave të inoksit me dimensione 100x100x5 mm me kanker bulona. Mbajtësit kryesor montohen në distancë 120 cm. Dorëza e gardhit për të rritur të punohet nga tubi i inoksit Ø 60x3 mm në lartësi 100 cm ndërsa dorëza e gardhit për fëmijë nga tubi i inoksit Ø 60x3 mm në lartësi 60 cm. Mbushja e rrethojës të bëhet me shufra Ø 10 mm në çdo 10 cm.	m'	14.30	100.00 €	1,430.00 €
1.15.06	Furnizimi me material dhe montimi i dorëzave në muret e shkallëve të brendshme me anë të shufrave për ankerim në çdo 120 cm. Dorëza e gardhit për të rritur të punohet nga tubi i inoksit Ø 60x3 mm në lartësi 100 cm ndërsa dorëza e gardhit për fëmijë nga tubi i inoksit Ø 60x3 mm në lartësi 60 cm.	m'	14.60	50.00 €	730.00 €
1.15.07	Furnizimin e materialit montimi i rigolave nga betoni me trashesi 8cm dhe dimensione standard.	m'	49.50	15.00	742.50 €
1.15.08	Furnizimi me material si dhe vendosja e llajsneve nga llamarina e plastifikuar tek fuga e dilatimit ne pjeset e jashtme te objektit fasade, me gjeresi 8-12cm.	m'	17.00	12.00 €	204.00 €
1.15.09	Furnizimi me material si dhe vendosja e llajsneve nga inox-i tek dyert ne dysheme.	m'	63.80	7.00 €	446.60 €
1.15.10	Furnizimi me material si dhe vendosja e llajsneve ne pjeset e brendeshme te objektit tek fuga e dilatimit nga materiali - inox, me gjeresi 8-12cm.	m'	2.55	7.00 €	17.85 €
1.15.11	Furnizimi me material dhe montimi i siroporit me trashesi t=10cm ne pjeset ku lidhet objekti i vjeter me aneksin.	m^2	36.90	8.00 €	295.20 €
1.15.12	Furnizimi me material si dhe mbjellja e drunjeve dekorative pisha apo bliri, me lartesi ~200cm.	cope	20.00	35.00	700.00 €
1.15.13	Furnizimi me material si dhe sjellja e dheut cilesor t=15cm, shtrirja dhe ngjeshja e tije ne pjesen e parterit, mbjellja e barit cilesor.	m^2	250.00	3.50	875.00 €
1.15.14	Furnizimi, tansporti, vendosja e shportave per mbeturina.Shportat e mbeturinave duhet te jene sipas kodit PF 06. Ne cmim te llogaritet edhe fiksimi dhe ankerimi ne toke.	cope	5.00	50.00	250.00 €
1.15.15	Sjellja e materialit, punimi dhe fiksimi i ulseve ne oborr, sipas sndardeve. Uleset do te punohen me pjeseza druri te cilesis se larte, konstruksion te lyre me profile celiku.	cope	5.00	150.00	750.00 €
1.15.16	Furnizimi dhe montimi i drrasave mbrojtese te mureve nga karrigat dhe bankat. Material i klasit te pare me gjeresi 20cm dhe trashesi 2cm (material adekuat per keto qellime), te ankerohen me bulona jokoridiv dhe te ngjyrosen sipas standardeve ndertimore.	m'	324.60	5.50	1,785.30 €
1.15.17	Furnizimi me material si dhe montimi i vareseve te teshave neper kthina te cakturara/klase, mardhesia e lyre varesisht prej kethines. Te behet ankerimi adekuat neper mure.	cope	12.00	30.00	360.00 €

1.15.18	Pastrimi i tërësishëm i objektit duke përfshirë pastrimin e pluhurit, pastrimin e dritareve, dyerve, dyshemeve dhe nyjeve sanitare me mjete higjienike dhe dezinfektuese nga brenda dhe jashtë duke përfshirë edhe pastrimin e parterit dhe përgaditja për pranim-dorëzim të objektit.	komplet	1	500.00 €	500.00 €
		TOTAL POZICIONI		1.15	37,531.25 €

1.16	PUNËT E DETALIT DEKORUES PER PARAPET				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL
	Furnizimi me material si dhe punimi i dekorit per maskim dhe mbrojtjen e fancoil-it sipas elementeve te pershkruara ne pozicionet e meposhtme, duke perfshire ankorimin e tij deri ne finalizim: Llogaritja eshte bere komplet maskimin per nje Fancoil.sipas detalit ne projekt: A.01.11.4				
1.16.01	Profil metalik 20x40mm i galvanizuar per vendosjen e llamarines dekoruese, te ankeruara ne mur dhe ne dysheme ne distance ~1.0m'.sipas detalit.	cope	30.00	220.00 €	6,600.00 €
1.16.02	Llamarin metalike 3mm e galvanizuar me prerje/dizajn te percaktuar nga menaxheri i kontrates me CNC me dimensione (3220x750mm) apo me vrima sipas dizajnit te paraqitur tek pjesa grafike.				
1.16.03	Ankerimi me ankerbulon ne dysheme dhe ne mur.				
1.16.04	Dru i lameluar 400x3300mm, me trashesi t=25mm, per punimin e parapetit sipas detalit				
		TOTAL POZICIONI		1.15.10	6,600.00 €

	REKAPITULLIM	
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE	13,000.00 €
1.02	PUNËT E DEMOLIMIT	2,082.00 €
1.03	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT	17,570.00 €
1.04	PUNËT E BETONIT	118,534.40 €
1.05	PUNËT E ARMIMIT	78,861.58 €
1.06	PUNËT E MURATIMIT	34,533.50 €
1.07	PUNËT E SUVATIMIT	38,276.50 €
1.08	PUNËT E NGJYROSJES	3,526.30 €
